



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE FURNIZIMIT ME UJE DHE
LARGIMIT E PERPUNIMIT TE UJERAVE TE NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 71, datë 21.09.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E
SEANCËS DËGJIMORE ME PUBLIKUN NË PROCESIN E MIRATIMIT TË
TARIFAVE

Në zbatim të nenit 14, gërma “e” dhe “i”, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Rregulloren për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.
2. Vendimi i Komisioni Kombëtar Rregullator nr. 37, datë 06.09.2017, "Për miratimin e udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave" shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe të gjitha shoqëritë ujësjellës kanalizime për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani